

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77 / 16 Gusht 2010), dhe nenet 19 dhe 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikro-financiare dhe Institucioneve Financiare Jo-Bankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11 / 11 Maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 04 gusht 2022, miratoi këtë:

## **Rregullore mbi treguesin e mbulimit me likuiditet**

### **KAPITULLI I**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë kriteret për llogaritjen e kërkesës për mbulimin me likuiditet dhe nivelin minimal të treguesit të mbulimit me likuiditet të bankave për të siguruar që bankat kanë stok adekuat të aseteve likuide të cilësisë së lartë të lira që mund të shndërrohen lehtë dhe menjëherë në para të gatshme për të plotësuar kërkesat e tyre për 30 ditë kalendarike të një skenari stresues të likuiditetit.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha bankat në Republikën e Kosovës që janë të licencuara nga BQK-ja, duke përfshirë degët e bankave të huaja.

##### **Neni 2**

##### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë sikurse përkufizohen në Ligjin Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (në vijim: Ligji për Bankat) dhe/ose sipas përkufizimeve në vijim për qëllimin e kësaj rregullore:
  - 1.1. **Asetet e Nivelit 1** – nënkupton asetet me likuiditet dhe cilësi kreditore jashtëzakonisht të lartë sikurse përcaktohen në nenin 10 të kësaj rregullore;
  - 1.2. **Asetet e Nivelit 2** – nënkupton asetet me likuiditet dhe cilësi kreditore të lartë të ndara më tej në asete të Nivelit 2A dhe 2B në pajtueshmëri me nënkapitullin II të Kapitullit II të kësaj rregullore, sikurse përcaktohet në nenin 11 dhe 12 të kësaj rregullore;
  - 1.3. **Rezervë likuiditeti (ang. Liquidity buffer)** – nënkupton shumën e aseteve likuide që një bankë zotëron në pajtueshmëri me Kapitullin II të kësaj rregullore;

- 1.4. **Rrjedha dalëse neto të likuiditetit** – nënkupton shumën që përfitohet nga zbritja e rrjedhave hyrëse të likuiditetit nga rrjedhat dalëse të likuiditetit të bankës në pajtueshmëri me Kapitullin III të kësaj rregullore;
- 1.5. **Valutë e rëndësishme** – nënkupton të gjitha valutat ku detyrimet agregate të denominuara në një valutë të ndryshme nga valuta raportuese euro (në bilanc të gjendjes dhe jashtë bilancit të gjendjes) arrijnë ose tejkalojnë 5% të gjithëj detyrimeve të bankës;
- 1.6. **Shoqëritë tregtare** – nënkupton llojet e shoqërive tregtare sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi. Klasifikimi i shoqërive tregtare (bizneseve) do të bëhet në pajtim me Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim të Republikës së Kosovës në fuqi;
- 1.7. **Depozitë** – nënkupton një shumë të parave të paguara nga një person fizik ose person juridik ndaj një Banke, që është pranuar nga ajo Bankë me kusht që këto para të ripaguhen plotësisht, me ose pa interes apo premi, qoftë me kërkesë ose në një datë të caktuar ndaj atij personi fizik ose personi juridik;
- 1.8. **Depozitat me pakicë (ang. retail)** – nënkupton një detyrim ndaj një personi fizik ose ndaj një Ndërmarrje të Vogël dhe të Mesme, kur personi fizik apo Ndërmarrja e Vogël dhe e Mesme do të kualifikohej për klasën e ekspozimit “Ekspozimet ndaj individëve dhe bizneseve të vogla dhe të mesme” sipas qasjes së standardizuar për rrezikun kreditor, sipas nenit 51 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe kur depozitat agregate nga personi fizik apo NVM-të në baza grupore nuk tejkalojnë shumën prej 1,000,000 (një milion) eurove;
- 1.9. **Depozita jo me pakicë (ang. wholesale)** – nënkupton çdo depozitë që nuk është përfshirë në kategorinë e depozitave me pakicë;
- 1.10. **Financim** – nënkupton detyrimet në formë të borxhit që nuk janë përfshirë në kategorinë e depozitave;
- 1.11. **Klient financiar** – nënkupton një klient që kryen një apo më shumë aktivitete të listuara në nenin 44 të Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, apo është një nga këto institucione:
  - 1.11.1. një bankë;
  - 1.11.2. një institucion mikrofinanciar;
  - 1.11.3. një institucion financiar jobankar;
  - 1.11.4. një shoqëri investuese;
  - 1.11.5. një sigurues;
  - 1.11.6. një risigurues; dhe
  - 1.11.7. çdo entitet ligjor që kryen aktivitete financiare brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.
- 1.12. **Stres** – nënkupton një përkeqësim i papritur apo i konsiderueshëm në pozicionin e solvencës apo të likuiditetit të një banke për shkak të ndryshimeve të kushteve të tregut apo faktorëve ideosinkretik (faktorëve specifik të bankës) si rezultat i të cilëve ekziston rrezik i konsiderueshëm që banka e ka të pamundur të kryejë zotimet e saj ashtu sikurse arrijnë për pagesë brenda 30 ditëve kalendarike të ardhshme;

- 1.13. **Kreditë marginale** – nënkupton kreditë e kolateralizuara që lejohen ndaj klientëve për qëllim të marrjes së pozicioneve tregtuese me leverazh;
- 1.14. **Transaksion kreditimi i siguruar** – nënkupton çdo transaksion që shkakton një ekspozim të siguruar me kolateral që nuk përfshinë një dispozitë që i jep bankës të drejtën për të marrë margjinën së paku në baza ditore;
- 1.15. **Transaksion i bazuar në tregun e kapitalit** – nënkupton çdo transaksion që shkakton një ekspozim që sigurohet me kolateral që përfshinë një dispozitë që i jep të drejtë bankës për të marrë margjinën së paku në baza ditore;
- 1.16. **Financim tregtar** – nënkupton financimin, duke përfshirë garancitë, që lidhen me këmbimin e mallrave dhe shërbimeve përmes produkteve financiare të maturitetit afatshkurtër të fiksuar, kryesisht më pak se një vit, pa vazhdim automatik sikurse është përcaktuar në Aneksin I të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.

### **Neni 3**

#### **Kërkesa për mbulimin e likuiditetit**

1. Bankat duhet të mbajnë asete likuide, shuma e vlerave të të cilave mbulon rrjedhat dalëse të likuiditetit pas zbritjes së rrjedhave hyrëse të likuiditetit në kushte stresuese në mënyrë që të sigurohet që ato mbajnë nivele të rezervave të likuiditetit (ang. liquidity buffers) që janë adekuate për të përballuar çdo mosbalancim të mundshëm ndërmjet rrjedhave hyrëse dhe rrjedhave dalëse të likuiditetit sipas kushteve stresuese të ashpëra gjatë një periudhe tridhjetë ditore.
2. Bankat mund të shfrytëzojnë asetet e tyre likuide për të mbuluar rrjedhat dalëse neto të likuiditetit të tyre gjatë periudhave të stresit.
3. Bankat nuk duhet të llogarisin dyfish asetet likuide, rrjedhat hyrëse dhe rrjedhat dalëse të likuiditetit.

### **Neni 4**

#### **Treguesi i mbulimit me likuiditet**

1. Bankat duhet të llogarisin treguesin e mbulimit me likuiditet të barabartë me raportin ndërmjet rezervës së likuiditetit (ang. liquidity buffer) të bankës ndaj neto rrjedhave dalëse të likuiditetit përgjatë 30 ditëve kalendarike të periudhës stresuese, të shprehur si përqindje, në nivel individual dhe të konsoliduar në pajtim me formulën si në vijim:

$$\text{Treguesi i mbulimit me likuiditet (\%)} = \frac{\text{Rezerva e likuiditetit}}{\text{Neto Rrjedhat dalëse të likuiditetit gjatë 30 ditëve kalendarike të periudhës stresuese}}$$

2. Bankat duhet të mbajnë treguesin e mbulimit me likuiditet së paku 100%.
3. Bankat, pa rënë në kundërshtim me paragrafin 2 të këtij neni, mund të monetizojnë asetet e tyre likuide për të mbuluar rrjedhat dalëse neto të likuiditetit gjatë periudhave stresuese, edhe nëse një

shfrytëzim i tillë i aseteve likuide mund të ndikojë që treguesi i mbulimit me likuiditet të shënojë rënie nën 100% gjatë periudhave të tilla.

4. Banka, ku në çdo kohë treguesi i mbulimit me likuiditet ka shënuar rënie ose mund të pritët në mënyrë të arsyeshme që të shënojë rënie nën 100%, duhet të njoftojë BQK-në menjëherë dhe duhet të dorëzojë pa ndonjë vonesë të panevojshme në BQK një plan për rikthimin me kohë të pajtueshmërisë me paragrafin 2 të këtij neni.
5. Banka duhet të raportojë në BQK në baza ditore në fund të çdo dite të operimit përveç nëse BQK autorizon një raportim me frekuencë më të ulët dhe një vonesë të raportimit më të gjatë derisa të rikthehet pajtueshmëria në nivelin e përcaktuar në paragrafin 2 të kësaj rregullore.
6. BQK do të lejojë autorizime të tilla bazuar në situatat individuale të një banke dhe duke marrë parasysh shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të bankës.
7. BQK do të monitorojë implementimin e planit të rikthimit të pajtueshmërisë derisa treguesi i mbulimit me likuiditet është rikthyer në nivelin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni dhe mund të kërkojë rikthim më të shpejtë nëse është e domosdoshme.
8. Bankat duhet të llogarisin dhe monitorojnë treguesin e mbulimit me likuiditet në valutën raportuese dhe në secilën valutë që është subjekt i raportimit të veçantë në pajtueshmëri me udhëzimin metodologjik të përcaktuar nga BQK.
9. Bankat për qëllim të raportimit në baza të konsoliduara, sikurse përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të marrin parasysh dispozitat në vijim:
  - 9.1. asetet e një vendi të huaj që mbahen nga një filialë / degë e bankës në një vend të huaj mund të njihen si asete likuide për qëllime të konsolidimit kur kualifikohen si asete likuide sipas ligjit vendor të vendit të huaj që përcakton kërkesën për mbulimin me likuiditet dhe kur plotësojnë një nga kushtet në vijim:
    - 9.1.1. asetet plotësojnë të gjitha kërkesat e përcaktuara në Kapitullin II të kësaj rregullore;
    - 9.1.2. asetet nuk i plotësojnë kërkesat specifike të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj rregullore sa i përket madhësisë së emetimit të tyre por plotësojnë të gjitha kërkesat tjera të përcaktuara në rregullore;
    - 9.1.3. asetet e njohura në bazë të pikës 9.1.2. të paragrafit 9 të këtij neni mund të njihen deri në shumën e neto rrjedhave dalëse të stresuara të likuiditetit të ndodhura në një valutë të caktuar në të cilën janë të denominuara dhe që rrjedhin nga e njëjta filialë / degë e bankës në një vend të huaj.
  - 9.2. rrjedhat dalëse në një filialë/degë të bankës në një vend të huaj që janë subjekt sipas ligjit vendor të atij vendi të huaj që përcakton kërkesën për mbulimin me likuiditet në përqindje më të lartë sesa ato që përcaktohen në Kapitullin III të kësaj rregullore do të jenë subjekt i konsolidimit në pajtueshmëri me normat më të larta të përcaktuara në ligjin vendor të vendit të huaj;
  - 9.3. rrjedhat hyrëse të likuiditetit në një filialë / degë të bankës në një vend të huaj që janë subjekt sipas ligjit vendor të atij vendi të huaj që përcakton kërkesën për mbulimin me likuiditet në përqindje më të ulët sesa ato që përcaktohen në Kapitullin III të kësaj rregullore do të jenë subjekt i konsolidimit në pajtueshmëri me normat më të ulëta të përcaktuara në ligjin vendor të vendit të huaj;

9.4. për një filialë/degë të bankës në një vend të huaj që janë subjekt sipas ligjit vendor të atij vendi të huaj që përcakton kërkesën për mbulimin me likuiditet që janë ndryshe nga kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, llogaritjet për qëllim të konsolidimit do të përgatiten sipas kërkesave të kësaj rregullore.

## **Neni 5**

### **Skenarët e stresit për qëllime të llogaritjes së raportit të mbulimit me likuiditet**

1. Skenarët në vijim mund të konsiderohen si tregues/sinjalizues të rrethanave në të cilat banka mund të konsiderohet të jetë subjekt i një situatë stresi:
  - 1.1. tërheqja e një pjese të rëndësishme/konsiderueshme e depozitave me pakicë (ang. retail);
  - 1.2. një humbje e pjesshme ose e plotë e kapacitetit të financimit të pagarrantuar jo me pakicë (ang. wholesale), duke përfshirë depozitat jo me pakicë (ang. wholesale) dhe burimet e tjera të financimit kontingjent të tilla si likuiditeti i pranuar i zotuar apo i pazotuar ose linjat kreditore;
  - 1.3. një humbje e pjesshme ose e plotë e financimit afatshkurtër të siguruar;
  - 1.4. rrjedha dalëse shtesë e likuiditetit si rezultat i një përkeqësimi në vlerësimin kreditor të bankës deri në tri shkallë (ang. notches);
  - 1.5. rritja e luhatshmërisë/paqëndrueshmërisë së tregut që ndikon në vlerën e kolateralit apo kualitetit të tij ose krijimi i nevojave shtesë për kolateral;
  - 1.6. tërheqjet e paplanifikuara në lehtësirat e likuiditetit dhe ato kreditore, që banka u ka dhënë klientëve të saj;
  - 1.7. detyrimi i mundshëm për të riblerë borxhin apo të kryejë obligimet jokontraktuale.

## **KAPITULLI II**

### **REZERVA E LIKUIDITETIT (ANG. LIQUIDITY BUFFER)**

#### **NËNKAPITULLI I**

#### **Kërkesat e përgjithshme**

### **Neni 6**

#### **Përbërja e rezervës së likuiditetit**

1. Në mënyrë që të kualifikohen për të qenë pjesë e rezervës së likuiditetit të bankës, asetet likuide duhet të jenë në pajtueshmëri me secilën nga kërkesat e mëposhtme:
  - 1.1. kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregullore;
  - 1.2. kërkesat operacionale të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregullore;
  - 1.3. kriteret përkatëse të pranueshmërisë për klasifikimin e tyre si aset i Nivelit 1 ose i Nivelit 2 në pajtueshmëri me Nënkapitullin II të këtij Kapitulli.

## Neni 7

### Kërkesat e përgjithshme për asetet likuide

1. Në mënyrë që të kualifikohen si asete likuide, asetet e bankës duhet të jenë në pajtueshmëri me paragrafët 2 deri 6 të këtij neni.
2. Asetet duhet të jenë në formën e një të drejte, pretendimi ose interesi që mbahet nga banka, ose përfshihet në një grup (ang. pool) sikurse përcaktohet në nënparagrafin 2.1. të këtij neni , dhe është i lirë nga çdo barrë apo detyrim (pa asnjë pengesë). Për ato qëllime, një aset konsiderohet të jetë i lirë nga çdo barrë apo detyrim nëse nuk është subjekt i ndonjë kufizimi ligjor, kontraktual, rregullator apo ndonjë kufizim tjetër që e ndalon bankën nga likuidimi, shitja, transferimi ose cedimi i të drejtave që rrjedhin nga e drejta e pronësisë, ose në përgjithësi largimin e asetit nga portfolio e bankës përmes shitjes me të drejta të plota ose përmes marrëveshjes së riblerjes brenda 30 ditëve të ardhshme kalendarike. Asetet në vijim duhet të konsiderohen të jenë të lira nga çdo barrë apo detyrim:
  - 2.1. asetet e përfshira në grup që janë në dispozicion për shfrytëzim të menjëhershëm si kolateral për të përfituar financim shtesë sipas linjave kreditore të zotuar por ende të pafinancuara ndaj bankës ose, nëse grupi i aseteve (ang. pool) është nën operimin e një banke qendrore, sipas linjave kreditore të pazotuar dhe të pafinancuara në dispozicion për bankën. Bankat duhet të supozojnë që asetet në grup janë të ngarkuara (të penguar) në mënyrë që të rritet likuiditeti në bazë të klasifikimit të likuiditetit të përcaktuar në Nënkapitullin II, duke filluar me asetet e papranueshme për rezervën e likuiditetit ;
  - 2.2. asetet që banka ka marrë si kolateral për qëllim të zbutjes së rrezikut kreditor në transaksionet e ndërsjellta të marrëveshjes së riblerjes apo transaksioneve të financimit të letrave me vlerë dhe që banka mund t'i shesë;
3. Asetet nuk duhet të jenë të emetuara nga vetë banka, aksionari i saj, përveç rastit kur aksionari është subjekt i sektorit publik që nuk është bankë, nga një filialë e saj ose ndonjë filialë tjetër e aksionarit të saj ose nga një Entitet Sekjuritizimi për Qëllime të Veçanta (ESQV) me të cilin banka ka lidhje të ngushta.
4. Asetet nuk duhet të jenë të emetuara nga:
  - 4.1. një bankë tjetër, përveç rasteve kur emetuesi është një entitet i sektorit publik që përcaktohet në nenin 10, paragrafin 1, nënparagrafin 1.3. dhe në nenin 11, paragrafin 1, nënparagrafin 1.1. të kësaj rregullore;
  - 4.2. një institucion mikrofinanciar;
  - 4.3. një institucion financiar jobankar;
  - 4.4. një shoqëri investuese;
  - 4.5. një sigurues;
  - 4.6. një risigurues; dhe
  - 4.7. çdo person juridik që kryen aktivitete financiare në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj.
5. Për qëllim të këtij neni, ESQV do të konsiderohet si entitet i papërfshirë në kuadër të entiteteve që përcaktohen në paragrafin 4, nënparagrafin 4.7 të këtij neni.

6. Vlera e aseteve duhet të jetë e mundshme të përcaktohet në bazë të çmimeve të tregut të publikuara gjerësisht dhe të disponueshme lehtësisht. Në mungesë të këtyre çmimeve të tregut, vlera e aseteve duhet të jetë e mundshme të përcaktohet në bazë të një formule të thjeshtë që përdorë të dhëna të publikuara dhe që bazohet në supozime të vërteta (realiste).
7. Asetet duhet të jenë të listuara në një bursë të njohur ose të tregtueshme përmes shitjes me të drejta të plota ose transaksioneve të thjeshta të riblerjes në tregjet e riblerjes të pranuar përgjithësisht. Këto kritere duhet të vlerësohen nga banka për secilin treg në mënyrë të veçantë. Një aset i pranuar për tregtim në një treg të organizuar që nuk është një bursë e njohur do të konsiderohet likuid vetëm kur ky treg i organizuar është aktiv dhe me madhësi për shitjet me të drejta të plota të aseteve. Banka duhet të merr parasysh kriteret minimale në vijim për të vlerësuar nëse një vend i tregtimit parashikon një treg aktiv dhe të konsiderueshëm për qëllime të këtij paragrafi:
  - 7.1. të dhënat historike për likuiditetin e tregut (gjerësinë dhe thellësinë e tregut) të dëshmuara nga margjinat e ulëta të çmimit të ofruar dhe atij të kërkuar (ang. bid-ask spread), vëllimi i lartë i transaksioneve të tregtimit dhe një numri të lartë dhe të diversifikuar të pjesëmarrësve të tregut;
  - 7.2. praninë së një infrastrukture të qëndrueshme të tregut.
8. Kërkesat e përcaktuara në paragrafin 6 dhe 7 të këtij neni nuk do të zbatohen për:
  - 8.1. kartëmonedhat dhe monedhat e përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. të kësaj rregullore;
  - 8.2. ekspozimet ndaj bankave qendrore të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. dhe 1.4. dhe neni 11 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të kësaj rregullore;
  - 8.3. ekspozimet ndaj qeverive qendrore të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të kësaj rregullore.

## **Neni 8**

### **Kërkesat operacionale**

1. Bankat duhet të hartojnë politika të brendshme dhe të përcaktojnë limite për të siguruar që mbajtja e aseteve likuide që përfshijnë rezervën e tyre të likuiditetit të mbetet e diversifikuar në mënyrë të përshtatshme në çdo kohë. Për këto qëllime, bankat duhet të marrin parasysh shkallën e diversifikimit ndërmjet kategorive të ndryshme të aseteve likuide dhe brenda kategorisë së njëjtë të aseteve likuide të përcaktuara në Nënkapitullin II të këtij Kapitulli dhe çdo faktorë tjetër relevant diversifikues, të tillë si llojet e emetuesve, kundërpalët apo vendndodhjet gjeografike të këtyre emetuesve dhe kundërpalëve.
2. BQK mund të caktojë kufizime specifike ose kërkesa në asetet likuide të bankës për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, megjithatë kufizimet ose kërkesat e tilla nuk do të aplikohen për:
  - 2.1. kategoritë e aseteve të nivelit 1 si në vijim:
    - 2.1.1. kartëmonedhat dhe monedhat e përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. të kësaj rregullore;

- 2.1.2. ekspozimet ndaj bankave qendrore të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. dhe 1.4. dhe neni 11 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. të kësaj rregullore.
- 2.1.3. asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga bankat multilaterale zhvillimore dhe organizatat ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5. të kësaj rregullore;
- 2.2. kategoritë e aseteve të nivelit 1 që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga qeveritë qendrore apo rajonale, autoritetet lokale apo entitetet e sektorit publik të përcaktuara në nenin 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 dhe 1.4. të kësaj rregullore, me kusht që banka mbanë asetet përkatëse për të mbuluar rrjedhat dalëse neto të stresuara të ndodhura në valutën në përdorim apo asetë është emetuar nga qeveritë qendrore apo rajonale, autoritetet lokale ose entitetet e sektorit publik të vendeve të huaja;
3. Bankat duhet të kenë qasje të menjëhershme në asetet likuide që zotërojnë dhe duhet të jenë në gjendje t'i monetizojnë ato në çdo kohë gjatë periudhës së stresit të 30 ditëve kalendarike përmes shitjes me të drejta të plota ose marrëveshjes së riblerjes në tregjet e riblerjes të pranuar përgjithësisht.
4. Për qëllim të paragrafit 3 të këtij neni, banka duhet të marrë parasysh asetet si në vijim:
  - 4.1. Një aset likuid do të konsiderohet si i çashëm menjëherë nga banka nëse nuk ekzistojnë pengesa ligjore ose praktike në mundësinë e bankës për të monetizuar një aset të tillë në kohën e duhur;
  - 4.2. Asetet e përdorura për lejime të kredive në transaksionet e strukturuar ose për të mbuluar shpenzimet operationale të bankave nuk do të konsiderohen si të çashme menjëherë nga banka;
  - 4.3. Asetet e mbajtura në një vend të huaj kur ekzistojnë kufizime për transferimin e lirë të tyre do të konsiderohen si të çashme menjëherë vetëm për pjesën që banka i përdorë ato asete për të plotësuar rrjedhat dalëse të likuiditetit në atë vend të huaj;
  - 4.4. Asetet e mbajtura në valutë të pakonvertueshme do të konsiderohen si të çashme menjëherë vetëm për pjesën sa banka i përdorë ato asete për të plotësuar rrjedhat dalëse të likuiditetit në atë valutë.
5. Bankat duhet të sigurojnë që asetet e tyre likuide janë nën kontrollin e funksionit specifik të menaxhimit të likuiditetit brenda bankës. Pajtueshmëria me këtë kërkesë do të provohet ndaj BQK-së përmes:
  - 5.1. vendosjes së aseteve likuide në një grumbull të veçantë nën menaxhimin e drejtpërdrejtë të funksionit të likuiditetit dhe me qëllim të vetëm të përdorimit të tyre si burim i fondeve kontingjente (emergjente), duke përfshirë edhe gjatë periudhave të stresit.
  - 5.2. duke krijuar sisteme të brendshme dhe kontrolla që i japin funksionit të menaxhimit të likuiditetit kontrollë efektive operationale për të monetizuar mbajtjen e aseteve likuide në çdo moment gjatë periudhës së stresit prej 30 ditëve kalendarike dhe të kenë qasje në fondet kontingjente (emergjente) pa rënë në konflikt me çdo strategji ekzistuese të biznesit apo të menaxhimit të rrezikut. Në veçanti, një aset nuk duhet të përfshihet në rezervën e likuiditetit ku shitja e tij pa e zëvendësuar gjatë periudhës së stresit prej 30 ditëve kalendarike do të



përfundonte mbrojtjen (ang. hedge) që do të krijonte një pozicion të hapur rreziku që tejkalon limitet e brendshme të bankës; ose

- 5.3. një kombinim i përcaktimeve sipas nënparagrafit 5.1 dhe 5.2., me kusht që BQK e parasheh të pranueshme një kombinim të tillë;
6. Bankat, vazhdimisht dhe së paku një herë në vit duhet të monetizojnë një mostër përfaqësuese të mjaftueshme të aseteve të tyre likuide përmes mjeteve të shitjes me të drejta të plota ose marrëveshjes riblerëse të thjeshtë në tregjet riblerëse të pranuarra përgjithësisht. Bankat duhet të zhvillojnë strategji për shitjen e mostrave të aseteve likuide që janë të përshtatshme për të:
  - 6.1. testuar qasjen në treg për ato asete dhe përdorimin e tyre;
  - 6.2. kontrolluar nëse proceset e bankës për monetizimin me kohë të aseteve janë efektive;
  - 6.3. minimizuar rrezikun e dhënies së sinjaleve negative në treg si rezultat i monetizimit të aseteve të bankës gjatë periudhave të stresit;
7. Kërkesa e përcaktuar në nënparagrafin 6.1. të paragrafit 6 të këtij neni nuk do të aplikohet në asetet e Nivelit 1 të përcaktuar në nenin 10 të kësaj rregullore.
8. Kërkesa e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni nuk do të kufizojë bankat nga mbrojtja (ang. hedging) për rrezikun e tregut që lidhet me asetet e tyre likuide me kusht që të plotësohen kriteret në vijim:
  - 8.1. banka harton procedura të brendshme në përputhje me paragrafin 3 dhe 5 të këtij neni, duke siguruar që ato asete vazhdojnë të jenë lehtësisht të disponueshme dhe nën kontrollin e funksionit të menaxhimit të likuiditetit;
  - 8.2. Rrjedhat dalëse neto dhe rrjedhat hyrëse neto të likuiditetit që rezultojnë në rast të një mbyllje të hershme të mbrojtjes (ang. hedge) merren parasysh në vlerësimin e një aseti relevant në pajtim me nenin 9 të kësaj rregullore.

## **Neni 9**

### **Vlerësimi i Aseteve Likuide**

Për qëllim të llogaritjes së treguesit të mbulimit me likuiditet, banka duhet të përdorë vlerën e tregut të aseteve likuide të saj. Vlera e tregut e aseteve likuide do të zvogëlohet në pajtueshmëri me faktorët zvogëlues (ang. haircut) të përcaktuar në Nënkapitullin II dhe në nenin 8 paragrafi 8, nënparagrafi 8.2. të kësaj rregullore, në rastet kur është e zbatueshme.

## **NËNKAPITULLI II**

### **ASETET LIKUIDE**

## **Neni 10**

### **Asetet e Nivelit 1**

1. Asetet e Nivelit 1 përfshijnë vetëm asetet që klasifikohen në një ose në disa nga kategoritë e mëposhtme dhe që plotësojnë në çdo rast kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në vijim:

1.1. monedhat dhe kartëmonedhat;

1.2. ekspozimet në vijim ndaj bankave qendrore:

1.2.1. asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, duke përjashtuar asetet e përcaktuara në pikën 1.2.3 të këtij nënparagrafi;

1.2.2. asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga Bankat Qendrore të vendeve të huaja, me kusht që ekspozimeve ndaj Bankës Qendrore ose Qeverisë Qendrore të këtyre vendeve, u është caktuar vlerësimi kreditor nga një Institucion i Vlerësimit të Jashtëm Kreditor (IVJK) që është së paku i shkallës së cilësisë kreditore 1 në përputhje me nenin 44, paragrafi 2 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;

1.2.3. rezerva e detyrueshme e likuiditetit e mbajtur nga banka në BQK, deri në masën e lejuar të përdorimit të saj, sipas rregulloreve të BQK-së në fuqi, si dhe për filialet ose degët e bankës në vende të huaja, rezerva e detyrueshme e likuiditetit e mbajtur në bankat qendrore të vendeve të përcaktuara në pikën 1.2.2 të nënparagrafit 1.2, të këtij neni, deri në masën e lejuar të përdorimit të saj, sikurse përcaktohet nga Bankat Qendrore përkatëse.

1.3. asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga qeveritë qendrore ose rajonale, autoritetet lokale ose entitetet e sektorit publik si në vijim:

1.3.1. qeveria e Republikës së Kosovës

1.3.2. qeveria qendrore e një vendi të huaj, me kusht që u është caktuar vlerësimi kreditor nga një Institucion i Vlerësimit të Jashtëm Kreditor (IVJK) që është së paku i shkallës së cilësisë kreditore 1 në përputhje me nenin 44, paragrafi 2 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;

1.3.3. qeveritë rajonale ose autoritetet lokale në një vend të huaj të llojit të tillë të përcaktuar në pikën 1.3.2. të këtij neni, me kusht që ato të trajtohen si ekspozime ndaj qeverisë qendrore të vendit të huaj në pajtueshmëri me nenin 45, paragrafi 3 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;

1.3.4. entitetet e sektorit publik me kusht që ato janë të trajtuara si ekspozime ndaj një prej qeverive rajonale ose autoriteteve lokale të përcaktuara në pikën 1.3.3. të këtij neni, në pajtueshmëri me nenin 46, paragrafi 6 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;

1.4. asetet në vijim:

1.4.1. asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore e një vendi të huaj ku banka operon përmes një filiale ose një dege, të cilave nuk u është caktuar vlerësimi kreditor i shkallës së cilësisë kreditore 1 nga një IVJK e emëruar në pajtueshmëri me nenin 44, paragrafi 2 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;

1.4.2. rezervat e detyrueshme e likuiditetit që mbahet nga banka në një bankë qendrore të përcaktuar në pikën 1.4.1. të këtij neni, deri në masën e lejuar të përdorimit të saj, sikurse përcaktohet nga Bankat Qendrore përkatëse;

- 1.4.3. shuma agregate e asetëve që mund të përfshihen në kuadër të pikave 1.4.1 dhe 1.4.2. të këtij neni dhe të denominuara në valutën e caktuar që banka mund t'i njohë si Asete të Nivelit 1 nuk duhet të tejkalojnë shumën e neto rrjedhave dalëse të stresuara të likuiditetit të ndodhura të bankës në valutën e njëjtë. Gjithashtu, në rastet kur një pjesë ose të gjitha asetet që mund të përfshihen në kuadër të pikave 1.4.1. dhe 1.4.2. të këtij neni janë të denominuara në një valutë që nuk është valutë vendore e vendit të huaj në fjalë, banka mund të njohë ato asetë si Asete të Nivelit 1 deri në shumën që është e barabartë me shumën e neto rrjedhave dalëse të stresuara të likuiditetit të ndodhura në atë valutë të huaj që korrespondon me operacionet e bankës në jurisdiksonin ku merret rreziku i likuiditetit.
- 1.5. asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga bankat multilaterale zhvillimore të përcaktuara në nenin 47, paragrafi 3 dhe organizatat ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 48 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave.

## **Neni 11**

### **Asetet e Nivelit 2A**

1. Asetet e Nivelit 2A do të përfshijnë vetëm asetet që klasifikohen në një ose në disa nga kategoritë e mëposhtme dhe që plotësojnë në çdo rast kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në vijim:
- 1.1. asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga qeveria qendrore ose banka qendrore e një vendi të huaj ose nga një qeveri rajonale, autoritet lokal ose entitet i sektorit publik në një vend të huaj, me kusht që u është caktuar pesha e rrezikut prej 20% në pajtueshmëri me nenin 44, paragrafi 2, nenin 45 paragrafi 2 dhe nenin 46 paragrafi 4 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, sipas rastit;
- 1.2. letrat me vlerë të borxhit të korporatave që plotësojnë të gjitha kërkesat në vijim:
- 1.2.1. kanë të përcaktuar një vlerësim kreditor nga një IVJK e emëruar që është së paku i shkallës së cilësisë kreditore 1 në pajtueshmëri me nenin 50 paragrafi 1, të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave ose një shkallë e cilësisë kreditore ekuivalente për rastet e vlerësimit kreditor afatshkurtër;
- 1.2.2. gjithsej vlera e emetimit të letrës me vlerë është së paku 250 milion euro (ose shuma ekuivalente në valutën vendore);
- 1.2.3. vlera maksimale e periudhës deri në maturitet e letrës me vlerë në momentin e emetimit është 10 vite.
2. Vlera e tregut të secilit nga asetet e Nivelit 2A është subjekt i zvogëlimit të vlerës (ang. haircut) prej së paku 15% nga banka.

## **Neni 12**

### **Asetet e Nivelit 2B**

1. Asetet e Nivelit 2B do të përfshijnë vetëm asetet që klasifikohen në një ose në disa nga kategoritë e mëposhtme dhe që plotësojnë në çdo rast kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në vijim:

- 1.1. asetet që përfaqësojnë kërkesat ndaj ose të garantuara nga banka qendrore ose qeveria qendrore e një vendi të huaj, me kusht që u është caktuar vlerësimi kreditor nga një IVJK e emëruar që është së paku i shkallës së cilësisë kreditore 3 në pajtueshmëri me nenin 44, paragrafi 2 të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;
- 1.2. letrat me vlerë të borxhit të korporatave që plotësojnë të gjitha kërkesat në vijim:
  - 1.2.1. kanë të përcaktuar një vlerësim kreditor nga një IVJK e emëruar që është së paku i shkallës së cilësisë kreditore 3 në pajtueshmëri me nenin 50 paragrafi 1, të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave ose një shkallë e cilësisë kreditore ekuivalente për rastet e vlerësimit kreditor afatshkurtër;
  - 1.2.2. gjithsej vlera e emetimit të letrës me vlerë është së paku 250 milion euro (ose shuma ekuivalente në valutën vendore);
  - 1.2.3. vlera maksimale e periudhës deri në maturitet të letrës me vlerë në momentin e emetimit është 10 vite.
2. Bankat duhet të aplikojnë një zvogëlim të vlerës (ang. haircut) prej 50% në vlerën e tregut të secilit nga asetet e Nivelit 2B, të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

### **Neni 13**

#### **Përbërja e rezervës së likuiditetit sipas nivelit të aseteve**

1. Bankat duhet të jenë në pajtueshmëri në çdo kohë me kërkesat në vijim në përbërjen e tyre në rezervën e likuiditetit:
  - 1.1. një minimum prej 60% të rezervës së likuiditetit duhet të përbëhet prej aseteve të Nivelit 1;
  - 1.2. një maksimum prej 15% të rezervës së likuiditetit mund të mbahet në asetet e Nivelit 2B.
2. Kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të aplikohen pas rregullimit për ndikimin në grupin e aseteve likuide të financimit të garantuar, transaksionet e kreditimit të garantuar ose transaksionet e kundërkëmbimit të kolateralit duke përdorur asetet likuide ku transaksionet maturojnë brenda 30 ditëve kalendarike, pas zbritjes së çdo zvogëlimi të vlerës (ang. haircuts) dhe me kusht që banka është në pajtueshmëri me kërkesat operacionale të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregullore.
3. Bankat duhet të përcaktojnë përbërjen e rezervës së tyre të likuiditetit në pajtueshmëri me formulën e përcaktuar në Aneksin I të kësaj rregullore.

### **Neni 14**

#### **Mosplotësimi i kërkesave**

Nëse një aset likuid nuk është në pajtueshmëri mëtutje me ndonjë nga kërkesat e përgjithshme të aplikueshme të përcaktuara në nenin 7 të kësaj rregullore, kërkesat operacionale të përcaktuara në nenin 8 paragrafi 3 të kësaj rregullore, ose ndonjë kriter të zbatueshëm të kriterit të përshtatshmërisë të përcaktuar në këtë Nënkapitull, banka ndalon njohjen e këtij asemi si aset likuid jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e ndodhjes së mosplotësimi të kërkesave.

**KAPITULLI III**  
**RRJEDHAT DALËSE DHE HYRËSE TË LIKUIDITETIT**

**NËNKAPITULLI I**  
**RRJEDHAT DALËSE NETO TË LIKUIDITETIT**

**Neni 15**

**Definicioni i neto rrjedhave dalëse të likuiditetit**

1. Rrjedhat dalëse neto të likuiditetit do të jenë shuma e rrjedhave dalëse në nën paragrafin 1.1. të këtij neni zvogëluar me shumën e rrjedhave hyrëse në nënparagrafin 1.2., por nuk do të jenë më të vogla se zero, dhe do të llogariten si në vijim:
  - 1.1. shuma e rrjedhave dalëse të likuiditetit sikurse përcaktohet në Nënkapitullin II të këtij Kapitulli;
  - 1.2. shuma e rrjedhave hyrëse të likuiditetit sikurse përcaktohet në Nënkapitullin III të këtij Kapitulli, të llogaritur si vlera më e ulët e rrjedhave hyrëse dhe 75% e rrjedhave dalëse.
2. Rrjedhat hyrëse dhe rrjedhat dalëse të likuiditetit do të vlerësohen gjatë një periudhe stresi prej 30 ditëve kalendarike, nën supozimin e një skenari të kombinuar ideosinkratik (specifik) dhe të tregut në përgjithësi (sistemik) sikurse përcaktohet në nenin 5 të kësaj rregullore.
3. Përllogaritja e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni duhet të kryhet në pajtueshmëri me formulën e përcaktuar në Aneksin II të kësaj rregullore.

**Neni 16**

**Netimi i transaksioneve derivative**

1. Bankat duhet të llogarisin rrjedhat dalëse dhe hyrëse të likuiditetit të pritshme përgjatë një periudhe prej 30 ditëve kalendarike për kontratat e listuara në Aneksin IV të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe për derivativët kreditor mbi baza neto sipas kundërpalëve që janë subjekt i ekzistimit të marrëveshjeve bilaterale të netimit.
2. Me përjashtim nga paragrafi 1 të këtij neni, bankat duhet të llogarisin rrjedhat dalëse dhe hyrëse të parasë së gatshme që rrjedhin nga transaksionet derivative në valutë të huaj që përfshijnë këmbim të plotë të shumave të principalit (kryegjësë) njëkohësisht (ose brenda ditës së njëjtë) në baza neto, edhe në rastet kur ato transaksione nuk janë të mbuluara nga marrëveshjet bilaterale të netimit.
3. Për qëllime të këtij neni, baza neto do të konsiderohet të jetë neto nga kolaterali që do të dorëzohet apo të merret gjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike. Megjithatë, në rastet kur kolaterali pranohet brenda 30 ditëve të ardhshme kalendarike, baza neto konsiderohet të jetë neto nga ky kolateral vetëm nëse plotësohen të dy kushtet në vijim:
  - 3.1. në rastin kur pranohet kolaterali do të kualifikohet si aset likuid sipas Kapitullit II Nënkapitulli II të kësaj rregullore;

- 3.2. banka duhet të jetë me të drejtë ligjore dhe operacionalisht në gjendje të ripërdorë kolateralin në rastin e pranimit.

## **NËNKAPITULLI II RRJEDHAT DALËSE TË LIKUIDITETIT**

### **Neni 17**

#### **Definicioni i rrjedhave dalëse të likuiditetit**

1. Rrjedhat dalëse të likuiditetit do të llogariten duke shumëzuar bilancet e mbetura të kategorive të ndryshme apo llojeve të detyrimeve dhe zotimeve jashtëbilancore me normat të cilat ato priten të tërhiqen ose të përdoren (ang. run off ose drawn down) sikurse përcaktohet në këtë Nënkapitull.
2. Rrjedhat dalëse të likuiditetit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni do të përfshijnë, në secilin rast të shumëzuar me normën dalëse të aplikueshme:
  - 2.1. shumën e mbetur aktuale për depozitat e qëndrueshme me pakicë dhe depozitat tjera me pakicë të përcaktuar në pajtueshmëri me nenet 19 dhe 20 të kësaj rregullore;
  - 2.2. shumat e mbetura aktuale të detyrimeve tjera që maturohen, që mund të kërkohen të paguhen nga emetuesi ose nga ofruesi i financimit ose që përmbajnë një pritshmëri nga ofruesi i financimit që banka të shlyejë detyrimin përgjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike në pajtueshmëri me nenet 21 dhe 22 të kësaj rregullore;
  - 2.3. rrjedhat dalëse shtesë të përcaktuara në pajtueshmëri me nenin 23 të kësaj rregullore;
  - 2.4. shumën maksimale që mund të tërhiqet përgjatë 30 ditëve të ardhshme kalendarike nga lehtësirat e zotuar të patërhequra/të papërdorura kreditore dhe të likuiditetit të përcaktuara në pajtueshmëri me nenin 24 të kësaj rregullore;
  - 2.5. rrjedhat dalëse shtesë të identifikuar në vlerësimin e produkteve dhe shërbimeve tjera sikurse përcaktohet në nenin 18 të kësaj rregullore.

### **Neni 18**

#### **Rrjedhat dalëse shtesë për produktet dhe shërbimet tjera**

1. Bankat duhet të vlerësojnë vazhdimisht mundësinë (probabilitetin) dhe vëllimin (sasinë) e rrjedhave dalëse të likuiditetit gjatë 30 ditëve kalendarike për produktet ose shërbimet të cilat nuk parashikohen në nenet 21 deri 24 të kësaj rregullore dhe të cilat ato i ofrojnë ose sponzorojnë ose të cilat blerësit e mundshëm do t'i konsideronin të ndërlidhura me to.
2. Këto produkte ose shërbime të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni do të përfshijnë, por pa u kufizuar në, rrjedhat dalëse që rezultojnë nga çdonjëra nga marrëveshjet kontraktuale për të cilat banka zbaton normat minimale të rrjedhave dalëse, të tilla si:
  - 2.1. 10% për detyrimet tjera jashtëbilancore dhe detyrimet e financimit kontingjent (emergjent), duke përfshirë lehtësirat e financimit të pazotuar, që mund të anulohen pa kushte në çdo kohë pa ndonjë njoftim;

- 2.2. 10% për kreditë e patërhequra dhe avanset ndaj kundërpalëve jo me pakicë, që mund të anulohen pa kushte në çdo kohë pa ndonjë njoftim;
  - 2.3. 100% për kreditë e siguruara me pasuri të paluajtshme që janë miratuar por që nuk janë tërhequr;
  - 2.4. 5% për kartelat kreditore, që mund të anulohen pa kushte në çdo kohë pa ndonjë njoftim;
  - 2.5. 7% për mbitërheqjet, që mund të anulohen pa kushte në çdo kohë pa ndonjë njoftim;
  - 2.6. 100% për rrjedhat dalëse të planifikuara që lidhen me rinovimin e kredive ekzistuese me pakicë (ang. retail) ose jo me pakicë (ang. wholesale) ose lejimin e kredive të reja me pakicë ose jo me pakicë;
  - 2.7. 100% për derivativët e pagueshëm të planifikuar dhe derivativët kreditor;
  - 2.8. 5% për produktet e lidhura me zërat jashtëbilancor të financimit tregtar.
3. Rrjedhat dalëse të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni do të vlerësohen sipas supozimit të një stresi të kombinuar ideosinkretik (specifik) dhe të gjithë tregut (sistemik) sikurse përcaktohet në nenin 5 të kësaj rregullore. Për këtë vlerësim, bankat veçanërisht duhet të marrin parasysht dëmin reputacional material që mund të rezultojë nga mos mbështetja me likuiditet për produktet dhe shërbimet e tilla.
  4. Bankat duhet të raportojnë së paku një herë në vit në BQK ato produkte dhe shërbime për të cilat mundësia dhe vëllimi i mundshëm i rrjedhave dalëse të likuiditetit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni janë materiale dhe BQK do të përcaktojë nëse do të rishikojë normat e caktuara të rrjedhave dalëse.

## **Neni 19**

### **Rrjedhat dalëse nga depozitat e qëndrueshme me pakicë**

1. Përveç rasteve kur plotësohen kriteret për norma më të larta të rrjedhave dalëse sipas nenit 20 paragrafi 2, 3, ose 8 të kësaj rregullore, shuma e depozitave me pakicë të mbuluara nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me Legjislacionin në fuqi mbi Sigurimin e Depozitave ose një skemë garantuese e depozitave ekuivalente në një vend të huaj do të konsiderohen si të qëndrueshme dhe shumëzohen me 5% në rastet kur depoziti është:
  - 1.1. pjesë e një marrëdhënieje të krijuar më parë me bankën, që e bën pothuajse të pamundur tërheqjen e depozitës; ose
  - 1.2. Mbahet në formën e një llogarie të transaksioneve (llogari rrjedhëse).
2. Për qëllim të paragrafit 1 nënparagrafit 1.1. të këtij neni, depozitë e qëndrueshme do të konsiderohet të jetë pjesë e një marrëdhënieje të krijuar më parë në rastet kur depozitori plotëson së paku një nga kriteret në vijim:
  - 2.1. ka një marrëdhënie kontraktuale aktive me bankën prej një kohëzgjatje së paku 12 mujore;
  - 2.2. ka një marrëdhënie huazimi me bankën për kreditë e mbuluara (garantuara) me kolateral në formë të pasurive të paluajtshme rezidenciale ose kredi tjera afatgjate;
  - 2.3. ka së paku një produkt tjetër aktiv me bankën, përveç kredisë.

3. Për qëllim të paragrafit 1 nënparagrafit 1.2. të këtij neni, një depozitë me pakicë do të konsiderohet që mbahet në llogari të transaksioneve (llogari rrjedhëse) në rastet kur paga, të ardhurat ose transaksionet, kreditohen dhe debitoohen rregullisht në atë llogari.

## **Neni 20**

### **Rrjedhat dalëse nga depozitat tjera me pakicë**

1. Bankat duhet të shumëzojnë me 10% depozitat tjera me pakicë, duke përfshirë edhe pjesën e depozitave me pakicë që nuk përfshihen në nenin 19 të kësaj rregullore, përveç rasteve kur zbatohen kushtet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni.
2. Depozitat tjera me pakicë do të jenë subjekt i normave më të larta të rrjedhave dalëse, sikurse përcaktohet nga banka, në pajtueshmëri me paragrafin 3 të këtij neni , në rastet kur plotësohen kushtet në vijim:
  - 2.1. gjithsej bilanci i depozitës, duke përfshirë të gjitha llogaritë e depozitave të klientit në bankë ose në grupin bankar ku banka bën pjesë, tejkalon 500,000 (pesëqind mijë) Euro.
  - 2.2. depozita është vetëm një llogari e çasshme interneti;
  - 2.3. depozita ofron një normë interesi që plotëson kushtet e mëposhtme:
    - 2.3.1. norma e interesit e tejkalon në mënyrë të konsiderueshme normën mesatare për produktet e ngjashme me pakicë;
    - 2.3.2. norma e kthimit të depozitës përcaktohet nga kthimi i një indeksi të tregut ose grupi indeksesh të tregut;
    - 2.3.3. norma e kthimit të depozitës përcaktohet nga faktorë të tjerë të tregut, të ndryshëm nga norma e interesit e ndryshueshme;
  - 2.4. depozita ishte vendosur fillimisht me afat të përcaktuar me datë të maturimit brenda periudhës prej 30 ditëve kalendarike ose depozita paraqet një periudhë njoftimi të përcaktuar më të shkurtër se 30 ditë kalendarike, në pajtueshmëri me marrëveshjet kontraktuale, me përjashtim të atyre depozitave që kualifikohen për trajtim të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni;
  - 2.5. depozituesi është jorezident në Kosovë ose depozita është e denominuar në një valutë të ndryshme nga euro. Për bankat ose filialet/degët në vende të huaja, depozituesi është jorezident në një vend të huaj ose depozita është e denominuar në një valutë tjetër të ndryshme nga valuta vendore që përdoret në vendin e huaj;
3. Bankat duhet të aplikojnë një normë më të lartë të rrjedhave dalëse të përcaktuara si në vijim:
  - 3.1. në rastet kur depozitat me pakicë e plotësojnë kriterin në nënparagrafin 2.1. ose dy nga kriteret në nënparagrafin 2.2. deri në 2.5 të paragrafit 2, të këtij neni do të aplikohet një normë e rrjedhës dalëse ndërmjet 10% dhe 15%;
  - 3.2. në rastet kur depozitat me pakicë plotësojnë kriterin e nënparagrafit 2.1., të paragrafit 2 të këtij neni dhe së paku një kriter të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, ose tri ose më shumë kriteret të paragrafit 2, të këtij neni do të aplikohet një normë e rrjedhës dalëse ndërmjet 15% dhe 20%.



4. Sipas rasteve, BQK mund të aplikojë një normë më të lartë të rrjedhave dalëse ku arsyetohet sipas rrethanave specifike të bankës. Bankat duhet të aplikojnë normën e rrjedhës dalëse të përcaktuar në paragrafin 3, nënparagrafin 3.2., të këtij neni për depozitat me pakicë ku vlerësimi i përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni nuk është kryer ose nuk është përfunduar.
5. Bankat mund të përjashtojnë nga llogaritja e rrjedhave dalëse disa kategori të kufizuara qartë të depozitave me pakicë për sa kohë që në çdo rast banka në mënyrë rigoroze zbaton dispozitat në vijim për gjithë kategorinë e këtyre depozitave, përveç kur ndonjë përjashtim mund të arsyetohet në bazë të rrethanave të vështira për depozitorin:
  - 5.1. brenda 30 ditëve kalendarike, depozituesi nuk lejohet të tërheqë depozitën; ose
  - 5.2. për tërheqjet e hershme brenda 30 ditëve kalendarike, depozitori duhet të paguajë një gjobë që përfshinë humbjen e interesit ndërmjet datës së tërheqjes dhe datës së maturitetit kontraktual plus një gjobë materiale që nuk duhet të tejkalojë interesin në vonesë për kohën e kaluar ndërmjet datës së depozitimit dhe datës së tërheqjes.
6. Nëse një pjesë e depozitës të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni mund të tërhiqet pa zbatuar gjobat përkatëse, vetëm ajo pjesë do të trajtohet si depozitë e kërkueshme dhe bilanci i mbetur do të trajtohet si depozitë me afat sikurse përcaktohet në këtë paragraf.
7. Një normë e rrjedhës dalëse prej 100% do të aplikohet për depozitat e anuluar me maturitet të mbetur më të shkurtë se 30 ditë kalendarike dhe kur pagesa është kontraktuar në një bankë tjetër.
8. Me përjashtim nga paragrafin 1 deri në 7 të këtij neni dhe neni 19 të kësaj rregullore, bankat duhet të shumëzojnë depozitat me pakicë që kanë pranuar në vendet e huaja me normë të përqindjes më të lartë të rrjedhës dalëse nëse një përqindje e tillë është siguruar nga legjislacioni vendor që përcakton kërkesat e likuiditetit në atë vend të huaj.

## **Neni 21**

### **Rrjedhat dalëse nga depozitat operacionale**

1. Bankat duhet të shumëzojnë me 25% detyrimet që rezultojnë nga depozitat që mbahen si në vijim:
  - 1.1. nga depozituesi për të marrë shërbime të (shlyerjes) kliringut, kujdestarisë, menaxhimit të parasë së gatshme ose shërbime tjera të krahasueshme në kontekstin e marrëdhënies operacionale të krijuar më parë me bankën;
  - 1.2. nga depozituesi në kontekstin e marrëdhënies operacionale të krijuar që është e ndryshme nga ajo e përcaktuar në nënparagrafin 1.1., të këtij neni.
2. Me përjashtim nga paragrafi 1 të këtij neni, bankat duhet të shumëzojnë me 5% pjesën e detyrimeve që rezultojnë nga depozitat e përcaktuara në paragrafin 1 nënparagrafi 1.1. të këtij neni, të mbuluara nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi mbi Depozitat e Siguruara ose një skemë e garantimit të depozitave ekuivalente në një vend të huaj.
3. Shërbimet e (shlyerjes) kliringut, kujdestarisë, menaxhimit të parasë së gatshme ose shërbime tjera të krahasueshme të përcaktuara në nënparagrafin 1.1. të paragrafit 1 të këtij neni, mbulojnë vetëm shërbimet e tilla në masën që ato janë ofruar në kontekst të një marrëdhënieje të krijuar më parë që është mjaftë e rëndësishme për depozituesin. Depozitat e përcaktuara në nënparagrafin 1.1. dhe 1.2. të paragrafit 1 të këtij neni do të kenë kufizime ligjore apo operacionale të konsiderueshme që

i bëjnë tërheqjet e konsiderueshme brenda 30 ditëve kalendarike të pamundshme. Fondet që tejkalojnë masën e kërkuar për shërbimet operacionale do të trajtohen si depozita jo-operacionale.

4. Depozitat që krijohen si rezultat i një marrëdhënieje me një bankë korrespondente ose nga ofrimi i shërbimeve të brokerimit nuk do të trajtohen si depozita operacionale dhe do të marrin një normë të rrjedhës dalëse prej 100%.
5. Në mënyrë që të identifikojë depozitat e përcaktuara në nënparagrafin 1.2. të paragrafit 1, të këtij neni, banka duhet të marrë parasysh që ekziston një marrëdhënie operacionale e krijuar me një klient jofinanciar, me përjashtim të depozitave të afatizuara, depozitave të kursimit dhe depozitave të brokerimit, në rastin kur plotësohen të gjitha kriteret në vijim:
  - 5.1. depozita zotërohet nga një klient jofinanciar;
  - 5.2. depozita nuk është depozitë e afatizuar ose llogari e kursimit;
  - 5.3. kompenzimi i llogarisë ka të përcaktuar çmimin së paku 5 pika bazë nën normën aktuale të depozitave jo me pakicë me karakteristika të krahasueshme, por që nuk janë negative;
  - 5.4. depozita mbahet në llogari të dedikuara (të veçanta) dhe i përcaktohet çmimi pa krijuar stimulime ekonomike për depozituesin për të mbajtur fondet në depozitë që tejkalon shumën e nevojshme për marrëdhënien operacionale;
  - 5.5. transaksionet materiale kreditohen dhe debitohen në baza të rregullta për transaksione të rëndësishme (materiale) të klientit;
  - 5.6. një nga kriteret në vijim është plotësuar:
    - 5.6.1. marrëdhënia me depozituesin ka ekzistuar së paku 24 muaj;
    - 5.6.2. depozita është përdorur për së paku 2 shërbime aktive. Këto shërbime mund të përfshijnë qasje direkte ose indirekte në shërbimet e pagesave vendore ose ndërkombëtare, tregtimin e letrave me vlerë ose shërbimet depozituese.
6. Vetëm pjesa e depozitës që është e nevojshme për të bërë përdorimin e shërbimit e të cilit depozita është krijuar do të trajtohet si depozitë operacionale. Pjesa e mbetur e depozitës do të trajtohet si depozitë jo-operacionale.

## **Neni 22**

### **Rrjedhat dalëse nga detyrimet tjera**

1. Bankat duhet të shumëzojnë me 40% detyrimet që rezultojnë nga depozitat e klientëve që janë klientë jo-financiar, qeveri qëndrore, banka qëndrore, banka shumëpalëshe të zhvillimit, ose entitete të sektorit publik, në masën që nuk përcaktohen sipas nenit 21 të kësaj rregullore.
2. Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, në rastet kur detyrimet e përcaktuara në paragrafin e parë janë të mbuluara nga Fondi i Sigurimit të Depozitave të Kosovës në pajtueshmëri me Legjislacionin mbi Sigurimin e Depozitave ose një skemë e garantimit të depozitave ekuivalente në një vend të huaj do të shumëzohen me 20%.
3. Bankat duhet të shumëzojnë detyrimet që rezultojnë nga shpenzimet operative të bankës me 0%.
4. Bankat duhet të shumëzojnë detyrimet që rezultojnë nga transaksionet e kreditimit të siguruara dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit që maturojnë brenda 30 ditëve kalendarike me:

- 4.1. 0% në rastet kur janë të kolateralizuara nga asete që, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikoheshin në pajtueshmëri me nenet 7 dhe 10 të kësaj rregullore si asete likuide të ndonjë prej kategorive të Aseteve të Nivelit 1, të përcaktuara në nenin 10 të kësaj rregullore;
- 4.2. 15% në rastet kur janë të kolateralizuara nga asete që, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikoheshin në pajtueshmëri me nenet 7 dhe 11 të kësaj rregullore si asete likuide të ndonjë prej kategorive të Aseteve të Nivelit 2A, të përcaktuara në nenin 11 të kësaj rregullore;
- 4.3. 25% në rastet kur janë të kolateralizuara me asete që nuk do të kualifikohen si asete likuide në pajtueshmëri me nenet 10 dhe 11 të kësaj rregullore dhe huadhënësi është Qeveria e Republikës së Kosovës, një entitet i sektorit publik, një qeveri rajonale ose një autoritet lokal në Republikën e Kosovës dhe qeveria qendrore, një entitet i sektorit publik, një qeveri rajonale ose një autoritet lokal i një vendi të huaj në të cilin banka ka qenë e licencuar ose ka themeluar një degë, ose një bankë shumëpalëshe e zhvillimit. Entitetet e sektorit publik që marrin këtë trajtim do të kufizohen në ato që kanë peshë rreziku prej 20% ose më të ulët në pajtueshmëri me nenin 45 dhe nenin 46, paragrafi 4 dhe 5 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;
- 4.4. 50% në rastet kur janë të kolateralizuara nga asete që, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikoheshin në pajtueshmëri me nenet 7 dhe 12 të kësaj rregullore si asete likuide të ndonjë prej kategorive të Aseteve të Nivelit 2B, të përcaktuara në nenin 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. të kësaj rregulloreje;
- 4.5. 100% në rastet kur janë të kolateralizuara nga asete që nuk kualifikohen për përfshirje në ndonjë nga nënparagrafët 4.1. deri 4.4. të këtij paragrafi.
- 4.6. Me përjashtim nga nënparagrafët 4.1. deri në 4.5., të këtij paragrafi, në rastet kur kundërpala në kreditimin e siguruar ose në transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit është banka qendrore vendore e bankës, norma e rrjedhës dalëse do të jetë 0%.
5. Kontratat e kundërkëmbimit të kolateralit (ang. collateral swaps), dhe transaksionet tjera të formës së ngjashme, që maturojnë brenda 30 ditëve të ardhshme do të shkaktojnë një rrjedhë dalëse në rastet kur aset i huazuar është subjekt i një faktori zvogëlues më të ulët sipas Nënkapitullit II sesa aset i dhënë hua. Rrjedha dalëse do të llogaritet duke shumëzuar vlerën e tregut të asetit të huazuar me diferencën ndërmjet normës së rrjedhës dalëse të aplikuar për asetin e dhënë hua dhe normës së rrjedhës dalëse të aplikuar për asetin e huazuar të përcaktuar në pajtueshmëri me normat e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni. Për qëllim të kësaj llogaritje, do të zbatohet faktori zvogëlues prej 100% për asetet që nuk kualifikohen si asete likuide. Me përjashtim prej normave të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni ku kundërpala në kundërkëmbimin e kolateralit ose të ndonjë transaksioni tjetër të formës së ngjashme është banka qendrore vendore e bankës, norma e rrjedhës dalëse që duhet të zbatohet ndaj vlerës së tregut të asetit të huazuar do të jetë 0%.
6. Bankat duhet të zbatojnë një normë të rrjedhave dalëse prej 100% për të gjitha vlerënotat, obligacionet dhe letrat me vlerë të borxhit të tjera të emetuara nga banka, me përjashtim të rasteve kur obligacioni është shitur në tregun me pakicë dhe mbahet në një llogari me pakicë, në të cilin rast këto instrumente mund të trajtohen si kategori e depozitave me pakicë adekuate. Kufizimet do të vendosen në mënyrë që këto instrumente të mos mund të blihen dhe të mbahen nga palët që nuk janë klientë me pakicë.

7. Asetet e huazuara të pasiguruar dhe që maturojnë brenda 30 ditëve të ardhshme kalendarike do të supozohet se tërhiqen plotësisht duke krijuar rrjedhë dalëse të aseteve likuide prej 100%, përveç rasteve kur banka i zotëron asetet e huazuara dhe asetet e huazuara nuk përbëjnë pjesë të rezervës së likuiditetit të bankës.
8. Për qëllim të këtij neni, 'bankë qendrore vendore' nënkupton ndonjë nga këto si në vijim:
  - 8.1. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
  - 8.2. banka qendrore e një vendi të huaj në të cilin banka është e licencuar për operim.

### **Neni 23**

#### **Rrjedhat dalëse shtesë**

1. Kolaterali që është i ndryshëm nga paraja e gatshme dhe asetet e përcaktuara në nenin 10 që dorëzohet nga banka për kontratat e listuara në Aneksin IV të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe derivativët kreditor, do të jenë subjekt i një rrjedhe dalëse shtesë prej 20%.
2. Banka duhet të llogarisë dhe njoftojë BQK-në për rrjedhën dalëse shtesë për të gjitha kontratat e lidhura, kushtet kontraktuale të të cilave, dhe një përkeqësim vijues i kualitetit kreditor të bankës shkaktojnë që brenda 30 ditëve kalendarike banka të ketë një rrjedhë dalëse shtesë të likuiditetit ose nevojave të kolateralit.
3. Bankat duhet të njoftojnë BQK-në për këtë rrjedhë dalëse të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, jo më vonë se data e dorëzimit të raportimit në pajtueshmëri me këtë rregullore.
4. Në rastet kur BQK konsideron që kjo rrjedhë dalëse sipas paragrafit 2 të këtij neni është materiale sa i përket rrjedhave dalëse shtesë të likuiditetit të bankës, do t'i kërkojë bankës të shtojë një rrjedhë dalëse shtesë për ato kontrata që korrespondojnë me nevoja shtesë të kolateralit ose rrjedha dalëse të parasë që rezulton nga përkeqësimi material në kualitetin kreditor të bankës që korrespondon në një përkeqësim në vlerësimin e saj kreditor të jashtëm prej së paku me tri shkallë. Banka duhet të zbatojë një normë të rrjedhës dalëse prej 100% për rrjedhat dalëse shtesë të kolateralit ose të parasë së gatshme. Banka në baza të rregullta do të rishikojë shkallën e këtij përkeqësimi material që është relevante sipas kontratave që ka lidhur dhe do të njoftojë rezultatin e këtij rishikimi në BQK.
5. Banka duhet të shtojë një rrjedhë dalëse shtesë që korrespondon me nevojat për kolateral që rezulton nga ndikimi i një skenari të tregut negativ në transaksionet derivative të bankës, nëse është materiale.
6. Rrjedhat dalëse dhe rrjedhat hyrëse të pritshme gjatë 30 ditëve kalendarike nga kontratat e listuara në Aneksin IV të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe nga derivativët kreditor do të merren parasysh në baza neto në pajtueshmëri me nenin 16 të kësaj rregullore. Në rastet e rrjedhës dalëse neto, banka duhet të shumëzojë rezultatin me një normë dalëse prej 100%. Bankat duhet të përjashtojnë nga llogaritjet e tilla ato kërkesa të likuiditetit që rezultojnë nga zbatimi i paragrafëve 1 deri në 5 të këtij neni.
7. Në rastet kur banka ka pozicion të shkurtë të mbuluar nga një huazim i letrës me vlerë të pasiguar, banka duhet të shtojë një rrjedhë dalëse shtesë që korrespondon me 100% të vlerës së tregut të letrave me vlerë ose aseteve tjera të shitura në pozicione të shkurta (ang. short) përveç nëse kushtet në bazë të të cilave banka i ka huazuar ato kërkojnë kthimin e tyre vetëm pas 30 ditëve kalendarike.

Në rastet kur pozicioni i shkurtë mbulohet nga një transaksion i financimit të letrave me vlerë të kolateralizuara, banka duhet të supozojë që pozicioni i shkurtë do të mbahet përgjatë periudhës së 30 ditëve kalendarike dhe do të marrë një rrjedhë dalëse prej 0%.

8. Banka duhet të shtojë një rrjedhë dalëse shtesë që korrespondon me 100% të:
  - 8.1. kolateralit shtesë që mban banka e që sipas kontratës mund të kërkohet në çdo kohë nga kundërpala;
  - 8.2. kolateralit që duhet t'i dorëzohet kundërpalës brenda 30 ditëve kalendarike;
  - 8.3. kolateralit që korrespondon në asetet që do të kualifikohen si asete likuide për qëllime të Kapitullit II të kësaj rregullore që mund të zëvendësohet për asetet që korrespondojnë në asetet që nuk do të kualifikohen si asete likuide për qëllime të Kapitullit II pa pëlqimin e bankës.
9. Depozitat e marra si kolateral nuk do të konsiderohen si detyrime për qëllime të nenit 19, 20, 21, 22 ose 24 paragrafi 7 dhe 8 të kësaj rregullore, por do të jenë subjekt i kërkesave të paragrafëve 1 deri në 8 të këtij neni kur është e zbatueshme. Shuma e parasë së gatshme e pranuar që tejkalon shumën e parasë së gatshme të pranuar si kolateral do të trajtohet si depozita në pajtueshmëri me nenet 19, 20, 21, 22 ose 24 paragrafi 7 dhe 8 të kësaj rregullore.
10. Sa i përket dispozitave të shërbimeve të brokerimit primar, në rastet ku banka ka mbuluar shitjet në pozicion të shkurtë të një klienti duke i përputhur (ang. matching) ato me asetet e një klienti tjetër, dhe asetet nuk kualifikohen si asete likuide, transaksionet e tilla do të jenë subjekt i një norme të rrjedhës dalëse prej 50% për një detyrim kontingjent.

## **Neni 24**

### **Rrjedhat dalëse nga lehtësirat kreditore dhe të likuiditetit**

1. Për qëllim të këtij neni, një lehtësirë likuiditeti do të konsiderohet çdo zotim, lehtësirë mbështetëse e papërdorur (ang. undrawn back-up facility) që do të përdoret për të rifinancuar detyrimet e borxhit të një klienti në situatat kur klienti i tillë nuk ka mundësi të rifinancojë (ang. rollover) atë borxh në tregjet financiare. Shuma e saj do të llogaritet si shumë e borxhit të emtuar nga klienti që është e papaguar aktualisht dhe që matoron brenda 30 ditëve kalendarike e që është e mbuluar nga kjo lehtësirë likuiditeti. Pjesa e lehtësirës së likuiditetit që e mbulon një borxh i cili nuk matoron brenda 30 ditëve kalendarike do të përjashtohet nga fushëveprimi i definicionit të lehtësirës. Çdo angazhim shtesë i lehtësirës së likuiditetit do të trajtohet si një lehtësirë kreditore e zotuar me normë të lidhur të tërheqjes sikurse përcaktohet në këtë nen. Lehtësirat e përgjithshme të kapitalit punues për korporatat nuk do të klasifikohen si lehtësira të likuiditetit, por si lehtësira kreditore.
2. Bankat duhet të llogarisin rrjedhat dalëse për lehtësira kreditore dhe të likuiditetit duke shumëzuar shumën e lehtësirave kreditore dhe të likuiditetit me normat e rrjedhave dalëse korresponduese të përcaktuara në paragrafin 3 deri në 5 të këtij neni. Rrjedhat dalëse nga lehtësirat kreditore dhe të likuiditetit do të përcaktohen si përqindje e shumës maksimale që mund të tërhiqet brenda 30 ditëve kalendarike, neto nga çdo kërkesë e likuiditetit që do të ishte e zbatueshme sipas nenit 18 për zërat jashtëbilancor të financimit tregtar dhe neto nga çdo kolateral në dispozicion për bankën dhe të vlerësuar në pajtueshmëri me nenin 9 të kësaj rregullore, me kusht që kolaterali i plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

- 2.1. mund të ripërdoret ose të hipotekohet nga banka;
- 2.2. mbahet në formë të aseteve likuide, por nuk është njohur si pjesë e rezervës së likuiditetit (ang. liquidity buffer); dhe
- 2.3. nuk përbëhet nga asetet e emetuara nga kundërpala e lehtësisë kreditore apo e likuiditetit ose një nga subjektet e ndërlidhura me të. Nëse informacioni i nevojshëm është në dispozicion për bankën, shuma maksimale që mund të tërhiqet për lehtësirat kreditore dhe të likuiditetit do të përcaktohet si shumë maksimale që mund të tërhiqet bazuar në detyrimet e kundërpalës ose bazuar në planin e tërheqjeve kontraktuale të parafinuar që parashikohen të realizohen përgjatë 30 ditëve kalendarike.
3. Shuma maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësirat kreditore të zotuar të papapërdorura dhe lehtësirat e likuiditetit të zotuar të patërhequra brenda 30 ditëve kalendarike do të shumëzohet me 5% nëse kualifikohen për klasën e ekspozimeve të depozitave me pakicë.
4. Shuma maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësirat kreditore të zotuar të papërdorura brenda 30 ditëve kalendarike do të shumëzohet me 10% në rastet kur plotëson kushtet në vijim:
  - 4.1. nuk kualifikohen për klasën e ekspozimeve të depozitave me pakicë;
  - 4.2. u janë dhënë klientëve që nuk janë klientë financiar, duke përfshirë korporatat jofinanciare, qeveritë qendrore, bankat qendrore, bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe entitetet e sektorit publik;
  - 4.3. nuk janë dhënë për qëllim të zëvendësimit të financimit të klientit në situatat kur klienti e ka të pamundur të sigurojë kërkesat e financimit në tregjet financiare.
5. Shuma maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësirat e likuiditetit të zotuar të patërhequra brenda 30 ditëve të ardhshme kalendarike do të shumëzohet me 30% kur i plotësojnë kushtet e përcaktuara në paragrafin 4, nënparagrafi 4.1 dhe 4.2., të këtij neni dhe me 40% kur u janë dhënë shoqërive investuese personale.
6. Banka mund të shumëzojë shumën maksimale që mund të tërhiqet nga lehtësirat tjera kreditore dhe të likuiditetit të zotuar të papërdorura brenda 30 ditëve kalendarike sipas normës së rrjedhëse dalëse korresponduese si në vijim:
  - 6.1. 40% për lehtësirat kreditore dhe të likuiditetit të dhëna bankave dhe për lehtësirat kreditore të dhëna institucioneve financiare tjera të rregulluara, përfshirë siguruesit (shoqëritë e sigurimit) dhe shoqëritë investuese.
  - 6.2. 100% për lehtësirat kreditore dhe të likuiditetit të dhëna klientëve financiar që nuk përcaktohet në nënparagrafin 6.1., të këtij paragrafi dhe paragrafët 1 deri në 5 të këtij neni.
7. Bankat duhet të shumëzojnë me normë të rrjedhëse dalëse prej 100% çdo detyrim që maturon brenda 30 ditëve kalendarike, përveç detyrimeve të përcaktuara në nenet 19 deri 24 të kësaj rregullore.
8. Në rastet kur gjithsej shuma e të gjitha zotimeve kontraktuale për të lejuar financim ndaj klientëve jofinanciar brenda 30 ditëve kalendarike, përveç zotimeve të përcaktuara në nenet 19 deri 24 të kësaj rregullore, tejkalon shumën e rrjedhëse hyrëse nga këta klientë jofinanciar të llogaritur sipas nenit 25 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1., shtesa do të jetë subjekt i një norme të rrjedhëse dalëse prej 100%. Për qëllim të këtij paragrafi, klientë jofinanciar do të përfshijnë por pa u kufizuar, personat

fizikë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, korporatat, qeveritë, bankat multilaterale zhvillimore dhe entitetet e sektorit publik, dhe do të përjashtohen klientët financiar dhe bankat qendrore.

### **NËNKAPITULLI III RRJEDHAT HYRËSE TË LIKUIDITETIT**

#### **Neni 25 Rrjedhat hyrëse**

1. Rrjedhat hyrëse do të vlerësohen gjatë periudhës së 30 ditëve kalendarike. Këto rrjedha do të përfshijnë vetëm rrjedhat hyrëse kontraktuale nga ekspozimet që nuk janë në vonesë dhe për të cilën banka nuk ka arsye të presë joperformancë brenda 30 ditëve kalendarike.
2. Bankat duhet të zbatojnë një normë hyrëse prej 100% për rrjedhat hyrëse të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, duke përfshirë në veçanti rrjedhat hyrëse në vijim:
  - 2.1. shumat për tu marrë nga bankat qendrore dhe klientët financiar me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë kalendarike;
  - 2.2. shumat për tu marrë nga letrat me vlerë që maturojnë brenda 30 ditëve kalendarike;
  - 2.3. shumat për tu marrë nga pozicionet në indekset kryesore të instrumenteve të kapitalit, me kusht që mos të përlogariten dy herë, si aktive likuide dhe si rrjedha hyrëse të likuiditetit. Këto shuma do të përfshijnë shumat që maturojnë sipas kontratave brenda 30 ditëve kalendarike, të tilla si dividendat në para të gatshme nga indekset e tilla kryesore dhe paratë për tu marrë nga instrumentet e tillë të kapitalit të shitur por që ende nuk janë shlyer, nëse nuk janë njohur si asete likuide në pajtueshmëri me Kapitullin II të kësaj rregulloreje;
3. Me përjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni, rrjedhat hyrëse të përcaktuara në këtë paragraf do të jenë subjekt i kërkesave si në vijim:
  - 3.1. shumat për tu marrë nga klientët jofinanciar me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë kalendarike, me përjashtim të shumave për tu marrë nga klientët nga transaksionet e financimit tregtar ose letrave me vlerë të maturuara, do të zvogëlohen për qëllime të pagesës së kryegjësë (principalit) për 50% nga vlera e tyre. Për qëllim të këtij nënparagrafi, termi “klientë jofinanciar” ka kuptimin e njëjtë sikurse në nenin 24 paragrafi 8 të kësaj rregulloreje;
  - 3.2. shumat për tu marrë nga transaksionet e kreditimit të siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit sikurse përkufizohen në nenin 2 të kësaj rregullore me maturitet të mbetur jo më të gjatë se 30 ditë kalendarike do të shumëzohen me:
    - 3.2.1. 0% në rastet kur janë të kolateralizuara nga asete që, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikoheshin në pajtueshmëri me nenet 7 dhe 10 të kësaj rregullore si asete likuide të ndonjë prej kategorive të Aseteve të Nivelit 1, të përcaktuara në nenin 10 të kësaj rregulloreje;
    - 3.2.2. 15% në rastet kur janë të kolateralizuara nga asete që, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikoheshin në pajtueshmëri me nenet 7 dhe 11 të kësaj rregullore si asete likuide të ndonjë prej kategorive të Aseteve të Nivelit 2A, të përcaktuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje;

- 3.2.3. 25% në rastet kur janë të kolateralizuara me asete që nuk do të kualifikohen si asete likuide në pajtueshmëri me nenet 10 dhe 11 të kësaj rregullore dhe huadhënësi është Qeveria e Republikës së Kosovës, një entitet i sektorit publik, një qeveri rajonale ose një autoritet lokal në Republikën e Kosovës dhe qeveria qendrore, një entitet i sektorit publik, një qeveri rajonale ose një autoritet lokal i një vendi të huaj në të cilin banka ka qenë e licencuar ose ka themeluar një degë, ose një bankë shumëpalëshe e zhvillimit. Entitetet e sektorit publik që marrin këtë trajtim do të kufizohen në ato që kanë peshë rreziku prej 20% ose më të ulët në pajtueshmëri me nenin 45 dhe nenin 46, paragrafi 4 dhe 5 i Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;
- 3.2.4. 50% në rastet kur janë të kolateralizuara nga asete që, për tu përdorur si kolateral për ato transaksione, do të kualifikoheshin në pajtueshmëri me nenet 7 dhe 12 të kësaj rregullore si asete likuide të ndonjë prej kategorive të Aseteve të Nivelit 2B, të përcaktuara në nenin 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. të kësaj rregullore;
- 3.2.5. 100% në rastet kur janë të kolateralizuara nga asete që nuk kualifikohen për përfshirje në ndonjë nga nënparagrafët 3.2.1. deri 3.2.4. të këtij paragrafi.
- 3.3. shumat për tu marrë nga kreditë margjinale kontraktuale që maturojnë brenda 30 ditëve të ardhshme kalendarike të dhëna kundrejt kolateralit të përbërë nga asetet jolikuide mund të marrin një normë të rrjedhës hyrëse prej 50%. Ato rrjedha hyrëse mund të konsiderohen në rastet kur banka nuk është duke e përdorur kolateralin që fillimisht e ka pranuar kundrejt kredive për të mbuluar ndonjë pozicion të shkurtë;
- 3.4. shumat për tu marrë që banka zotëron këto shuma i trajton në pajtueshmëri me nenin 21, do të shumëzohen me normën e rrjedhës hyrëse korresponduese simetrike. Në rastet kur nuk mund të caktohet norma korresponduese, do të zbatohet një normë e rrjedhës hyrëse prej 5%;
- 3.5. kontratat e kundërkëmbimit të kolateralit dhe transaksionet tjera me formë të ngjashme që maturojnë brenda 30 ditëve kalendarike do të shkaktojnë një rrjedhë hyrëse në rastet kur asetit i dhënë hua është subjekt i një faktori zvogëlues më të ulët sipas Nënkapitullit II sesa asetit i huazuar. Rrjedha hyrëse do të llogaritet duke shumëzuar vlerën e tregut të asetit të dhënë hua me diferencën ndërmjet normës së rrjedhës hyrëse të aplikuar për asetin e huazuar dhe normës së rrjedhës hyrëse të aplikuar për asetin e dhënë hua të përcaktuar në pajtueshmëri me normat e përcaktuara në nënparagrafin 3.2. të këtij neni. Për qëllim të kësaj llogaritje, do të zbatohet faktori zvogëlues prej 100% për asetet që nuk kualifikohen si asete likuide;
- 3.6. në rastet kur kolaterali i marrë përmes marrëveshjeve riblerëse të ndërsjellta, huazimit të letrave me vlerë, kundërkëmbimit të kolateralit, ose transaksionet tjera me formë të ngjashme që maturojnë brenda një periudhe prej 30 ditëve kalendarike, përdoret për të mbuluar pozicionet e shkurta që mund të tejkalojnë 30 ditë, banka duhet të supozojë që marrëveshjet riblerëse të tilla, kontratat e huamarrjes së letrave me vlerë, kundërkëmbimet e kolateralit ose transaksionet tjera me formë të ngjashme do të rinovohen përsëri dhe nuk do të krijojnë rrjedhë hyrëse që pasqyrojnë nevojën për të vazhduar të mbulojë pozicionin e shkurtë ose të riblej letrat me vlerë relevante. Pozicionet e shkurta do të përfshijnë dy nivelet në rastet ku në librin që përputhet (ang. matched book) banka ka shitur të drejtën e letrës me vlerë për shitje si pjesë e strategjisë së tregtimit ose mbrojtjes (ang. hedging) dhe niveleve ku në librin që përputhet banka ka huazuar një letër me vlerë për një periudhë të dhënë dhe ka kredituar letrën me vlerë për një periudhë më të gjatë;



- 3.7. lehtësirat e papërdorura kreditore ose të likuiditetit duke përfshirë lehtësirat e likuiditetit të zotuar të patërhequra nga bankat qendrore, nuk do të merren parasysh si një rrjedhë hyrëse;
  - 3.8. shumat e marra nga letrat me vlerë të emetuara nga banka ose ndonjë ESQV me të cilin banka ka lidhje të ngjushë do të merren parasysh në baza neto me një normë të rrjedhës hyrëse të zbatuar në bazë të normës së rrjedhës hyrëse të aplikueshme në asetin bazë sipas këtij neni;
  - 3.9. kreditë me datë kontraktuale të padefinuar të maturimit do të merren parasysh me një normë të rrjedhës hyrëse prej 20%, me kusht që kontrata e lejon bankën të tërheqë ose të kërkojë pagesën brenda 30 ditëve kalendarike.
4. Nënparagrafi 3.1. i paragrafit 3 të këtij neni nuk do të zbatohet për shumat për tu marrë nga kreditimi i siguruar dhe transaksionet e bazuara në tregun e kapitalit që janë të kolateralizuara nga asetet likuide në pajtueshmëri me Kapitullin II sikurse përcaktohet në nënparagrafin 3.2. të paragrafit 3 të këtij neni. Rrjedhat hyrëse nga lejimi i bilanceve që mbahen në llogari të ndara në pajtueshmëri me kërkesat rregullative për mbrojtjen e aseteve të tregtuara të klientëve do të merren parasysh plotësisht, me kusht që këto bilance të ndara mbahen në asete likuide sikurse definohen në Kapitullin II të kësaj rregullore.
  5. Rrjedhat dalëse dhe hyrëse të pritura gjatë 30 ditëve kalendarike nga kontratat e listuara në Aneksin IV të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe nga derivativët kreditor do të llogariten në baza neto në pajtueshmëri me nenin 16 të kësaj rregullore dhe do të shumëzohen me një normë të rrjedhës hyrëse prej 100% në rast të një rrjedhe hyrëse neto.
  6. Bankat nuk do të marrin parasysh çdo rrjedhë hyrëse nga çdo aset likuid i përcaktuar në Kapitullin II përveç pagesave për tu shlyer në asetet që nuk janë pasqyruar në vlerën e tregut të asetit.
  7. Bankat nuk do të marrin parasysh rrjedhat hyrëse nga çdo detyrim i ri që e kontraktojnë.
  8. Bankat duhet të marrin parasysh rrjedhat hyrëse të likuiditetit që janë për tu marrë në vendet e huaja ku ekzistojnë kufizimet e transferit ose që janë të denominuara në valuta të pakonvertueshme vetëm në masën që ato korrespondojnë me rrjedhat dalëse përkatëse në vendin e huaj ose në valutën konkrete.

## **Neni 26**

### **Limiti i Rrjedhave hyrëse**

1. Bankat duhet të kufizojnë njohjen e rrjedhave hyrëse të likuiditetit në 75% të gjithë rrjedhave dalëse të likuiditetit sikurse definohet në Kapitullin II të kësaj rregullore.
2. Bankat duhet të përcaktojnë shumën e rrjedhave dalëse neto të likuiditetit sipas aplikimit të limitit të rrjedhës hyrëse në pajtueshmëri me formulën e përcaktuar në Aneksin II në këtë rregullore.

**KAPITULLI IV**  
**RAPORTIMI, MASAT PËRMIRËSUESE, DISPOZITA KALIMTARE DHE HYRJA NË**  
**FUQI**

**Neni 27**

**Raportimi në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës**

1. Bankat duhet të dorëzojnë në BQK format e raportimit të përcaktuara nga BQK sipas udhëzimit metodologjik mbi raportimin e treguesit të mbulimit me likuiditet jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë (15) pas përfundimit të çdo muaji.
2. BQK nxjerr udhëzime për zbatimin e kësaj rregullore.

**Neni 28**

**Zbatimi, Masat përmirësuese dhe Dënimet Civile**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregullore do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese, sikurse përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për bankat.

**Neni 29**

**Shtojcat**

Pjesë përbërëse e kësaj rregullore janë Aneksi I dhe Aneksi II .

**Neni 30**

**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2023.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

## ANEKSI I

### FORMULA PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES SË REZERVËS SË LIKUIDITETIT

1. Bankat duhet të përdorin formulën e përcaktuar në këtë Aneks për të përcaktuar përbërjen e rezervës së likuiditetit në pajtueshmëri me nenin 13 të kësaj rregullore.
2. Llogaritja e rezervës së likuiditetit: në datën e llogaritjes, rezerva e likuiditetit të bankës do të jetë e barabartë me:
  - 2.1. shumën e aseteve të nivelit 1; plus
  - 2.2. shumën e aseteve të nivelit 2A; plus
  - 2.3. shumën e aseteve të nivelit 2B; minus shuma më e vogël:
  - 2.4. shuma e paraparë në pikat 2.1.,2.2.,dhe 2.3.; ose
  - 2.5. teprica e shumës së aseteve likuide sikurse llogaritet në pajtueshmëri me paragrafët 3 dhe 4 të këtij aneksi.
3. “Teprica e shumës së aseteve likuide”: kjo shumë do të përbëhet nga elementet e definuara si në vijim:
  - 3.1. shuma e aseteve të nivelit 1 e rregulluar, do të jetë e barabartë me vlerën e të gjitha aseteve likuide të nivelit 1 pas aplikimit të faktorëve zvogëlues (ang. haircut), që do të mbahen nga banka në rast të marrjes në konsideratë të transaksionit të financimit të siguar, transaksionit të huadhënies së kolateralizuar, ose transaksionit të kundërkëmbimit të kolateralit që matoron brenda 30 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes dhe kur banka dhe kundërpala këmbajnë asetet likuide së paku në njërën anë të transaksionit;
  - 3.2. shuma e aseteve të nivelit 2A e rregulluar, do të jetë e barabartë me vlerën pas aplikimit të zvogëlimit të vlerës së të gjitha aseteve të nivelit 2A që do të mbahen nga banka në rast të marrjes në konsideratë të transaksionit të financimit të siguar, transaksionit të huadhënies së kolateralizuar, ose transaksionit të kundërkëmbimit të kolateralit që matoron brenda 30 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes dhe kur banka dhe kundërpala këmbajnë asetet likuide së paku në njërën anë të transaksionit; dhe
  - 3.3. shuma e aseteve të nivelit 2B e rregulluar, do të jetë e barabartë me vlerën pas aplikimit të zvogëlimit të vlerës së të gjitha aseteve të nivelit 2B që do të mbahen nga banka në rast të marrjes në konsideratë të transaksionit të financimit të siguar, transaksionit të huadhënies së kolateralizuar, ose transaksionit të kundërkëmbimit të kolateralit që matoron brenda 30 ditëve kalendarike nga data e llogaritjes dhe kur banka dhe kundërpala këmbajnë asetet likuide së paku në njërën anë të transaksionit;
4. Llogaritja e “tepricës së shumës së aseteve likuide”: kjo shumë do të jetë e barabartë me:
  - 4.1. shumën e aseteve të nivelit 1 të rregulluar; plus
  - 4.2. shumën e aseteve të nivelit 2A të rregulluar; plus
  - 4.3. shumën e aseteve të nivelit 2B të rregulluar; minus
  - 4.4. shuma më e vogël nga:

4.5. shuma e pikës 4.1.,4.2., dhe 4.3.

4.6.  $100/30$ \* pika 4.1

4.7.  $100/60$ \* pika 4.1

4.8.  $100/85$  \* shuma e pikës 4.1 dhe 4.2.

5. Formula për llogaritjen e Rezervës së Likuditetit (ang. Liquidity Buffer) është si në vijim:

Rezerva e likuditetit = Asetet e Nivelit 1 + Asetet e Nivelit 2A + Asetet e Nivelit 2B – Rregullimi për limitin prej 15% - Rregullimi për limitin prej 40%.

Ku:

Rregullimi për limitin prej 15% = Maksimumi (Asetet e Nivelit 2B të rregulluara –  $15/85$ \* (Asetet e Nivelit 1 të rregulluara + Asetet e Nivelit 2A të rregulluara), Asetet e Nivelit 2B të rregulluara –  $15/60$  \* Asetet e Nivelit 1 të rregulluara, 0)

Rregullimi për limitin prej 40% = Maksimumi (Asetet e Nivelit 2A të rregulluara + Asetet e Nivelit 2B të rregulluara - Rregullimi për limitin prej 15% ) –  $2/3$  \* Asetet e Nivelit 1 të rregulluara, 0).

Në mënyrë alternative, formula mund të shprehet si:

Rezerva e likuditetit (ang. Liquidity Buffer) = Asetet e Nivelit 1 + Asetet e Nivelit 2A + Asetet e Nivelit 2B – Maksimumi ((Asetet e Nivelit 2A të rregulluara + Asetet e Nivelit 2B të rregulluara) –  $2/3$  \* Asetet e Nivelit 1 të rregulluara, Asetet e Nivelit 2B të rregulluara –  $15/85$  \* ( Asetet e Nivelit 1 të rregulluara + Asetet e Nivelit 2A të rregulluara),0)

## ANEKSI II

### FORMULA PËR LLOGARITJEN E NETO RRJEDHËS DALËSE TË LIKUIDITETIT

NRRDL = Neto rrjedha dalëse e likuditetit

GJRRD = Gjithsej rrjedhat dalëse

GJRRH = Gjithsej rrjedhat hyrëse

Rrjedhat hyrëse subjekt i limitit prej 75% të rrjedhave dalëse

Neto rrjedhat dalëse të likuditetit janë të barabarta =  $NRRDL = GJRRD - \text{Min} (GJRRH; 0.75 * GJRRD)$